

Në bazë të nenit 44 -70 të Ligjit mbi parandalim të korrupsionit ("Fleta zyrtare e Malit të Zi", numër 53/14), nenit 56 të Ligjit mbi mbrojtjen e të dhënave personale ("Fleta zyrtare e MZ", nr.79/08, 70/09 dhe 44/12) dhe nenit 101 të Statutit të Komunës së Tuzit ("Fleta zyrtare e Malit të Zi", numër 24/19), Kryetari i Komunës së Tuzit, më 26.09.2019 ka sjellë

## **UDHËZIM PËR VEPRIM SIPAS PARAQITJES DHE EVIDENCËS SË PARAQITJEVE TË KORRUPSIONIT BRENDA KOMUNËS SË TUZIT, SI DHE MBROJTJEN E IDENTITETIT TË PERSONAVE QË KANË DORËZUAR PARAQITJEN**

### **I. Dispozitat e përgjithshme**

#### **(Lënda)**

##### **Neni 1**

Me udhëzim për veprim sipas paraqitjes dhe evidencës së paraqitjeve të korrupsionit brenda Komunës së Tuzit, si dhe mbrojtjen e identitetit të personave që kanë dorëzuar paraqitjen (në tekstin e mëtejme: Udhëzim) rregullohet mënyra e raportimit të brendshëm të korrupsionit dhe parregullsi të tjera në Komunën e Tuzit (në tekstin e mëtejme: Komuna), veprimin sipas paraqitjeve të pranuar të korrupsionit dhe parregullsi të tjera, shqyrtimin e paraqitjeve të pranuar të korrupsionit dhe parregullsi të tjera, obligimi i njoftimit të personave që kanë paraqitur korrupsionin dhe parregullsitë e tjera mbi punët e ndërmarra, mbrojtja e personave të cilët paraqesin korrupsionin dhe parregullsitë e tjera dhe çështje të tjera të cilat janë të lidhura me paraqitjen e brendshme të korrupsionit dhe parregullsi të tjera në Komunë.

#### **(Përdorimi i gjuhës për gjininë e ndjeshme)**

##### **Neni 2**

Shprehjet të cilat përdoren në këtë Udhëzim për personat fizik të gjinisë mashkullore të njëjtat shprehje nënkuptohen edhe për gjininë femërore.

### **II. Paraqitja e brendshme e korrupsionit dhe parregullsi të tjera**

#### **(E drejta në paraqitje të brendshme të korrupsionit dhe parregullsi të tjera)**

##### **Neni 3**

Secili i punësuar në Komunës që ka njohuri ose prova materiale për ekzistimin e korrupsionit ose parregullsi të tjera në Komunë, mund të paraqesë paraqitje të brendshme për korrupsion ose parregullsi ose rrethana të tjera që tregojnë në ekzistencën e korrupsionit ose parregullsi të tjera (në tekstin e mëtejme: informatori).

Në kuptimin e këtij Udhëzimi:

- a) si korrupsion konsiderohen veprimet që kanë karakteristikat e veprës penale,
- b) si parregullsi të tjera konsiderohen veprimet që shkelin kodin e etikës ose shkeljen disiplinore, ose veprime që karakterizohen si kundërvajtëse.

Keqpërdorimi i të drejtës për raportim nga paragrafi 1 i këtij neni paraqet shkelje të detyrës.

E drejta për të raportuar brenda parregullsi të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni nuk ndikon në të drejtën e të punësuarit për të iniciuar procedurën disiplinore, në përputhje me rregulloret e përgjithshme të punës dhe dispozitat e Rregullores për procedurën e përcaktimit të përgjegjësisë disiplinore të të punësuarve në Komunën e Tuzit.

### **(Personi për pranim dhe veprim sipas paraqitjes së informatorit)**

#### **Neni 4**

Personi i caktuar për pranimin dhe veprimin sipas paraqitjes së informatorit nga neni 3 i këtij Udhëzimi, është i obliguar që për të verifikuar të vërtetën e të dhënave nga kërkesa, të iniciojë procedurën në afat prej tetë ditësh nga dita e parashtrimit të paraqitjes.

### **(Verifikimi i të vërtetës)**

#### **Neni 5**

Verifikimi i të vërtetës nga paraqitja nga neni 3 i këtij Udhëzimi do të bëhet me vështrim të drejtpërdrejtë të regjistrave zyrtarë, lëndëve, akteve dhe ambienteve zyrtare të Komunës, si dhe marrjen e deklaratave nga të punësuarit.

### **(Përpilimi i mendimit)**

#### **Neni 6**

Në bazë të procedurës së kryer të verifikimit të vërtetësisë nga paraqitja nga neni 3 i këtij Udhëzimi, personi që pranon dhe vepron sipas paraqitjes së informatorit përpilon mendimin mbi ekzistimin e rrezikimit të interesit publik, i cili tregon në ekzistimin e korrupsionit.

Nëse me kontrollin nga paragrafi 1 të këtij neni përcaktohet se ka ardhur deri te rrezikimi i interesit publik i cili tregon në ekzistimin e korrupsionit, mendimi nga paragrafi 1 i këtij neni përmban gjithashtu edhe propozimin e masave që kryetari i Komunës duhet të ndërmarrë për të parandaluar rrezikimin.

### **(Njoftim mbi masat e ndërmarra)**

#### **Neni 7**

Komuna është e detyruar që brenda 45 ditëve nga data e parashtrimit të paraqitjes, të informojë informatorin për masat e marra sipas paraqitjes së tij, gjegjësisht për rezultatet e masave të marra.

### **(Evidenca e paraqitjeve)**

#### **Neni 8**

Çdo paraqitje të pranuar, gjegjësisht shënim zyrtar mbi paraqitje, regjistrohet menjëherë nga personi që pranon dhe vepron sipas paraqitjes së informatorit në regjistrat qendror të të gjitha paraqitjeve të brendshme të korrupsionit dhe parregullsive të tjera.

Evidenca e paraqitjeve të informatorëve përmban të dhënat si në vijim: numrin rendor, datën e paraqitjes, emrin, mbiemrin dhe emërtimin e informatorit (nëse nuk është anonim), përshkrim i shkurtër i rrezikimit të interesit publik që tregon ekzistimin e korrupsionit të raportuar nga informatorët, njoftimin për veprimet e ndërmarra në bazë të nenit 7 të këtij Udhëzimi nëse i është dorëzuar informatorit, numrin dhe datën e raportit për zbatimin e masave të ndërmarra nga kryetari i Komunës për të parandaluar rrezikimin dhe të dhëna të tjera që lidhen me paraqitjen e informatorit.

Të dhënat nga evidencat nga paragrafi 2 i këtij neni, nuk mund të jepen në shfrytëzim përderisa dhënia e të dhënave të tilla mund të ndikojë në udhëheqjen e procedurës, si dhe në rastet e përcaktuara me Ligjin për parandalimin e korrupsionit dhe ligjet që rregullojnë fshehtësinë e të dhënave dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

### **(Mbrojtja e identitetit të informatorit)**

#### **Neni 9**

Çdo paraqitje të pranuar, të dhënat e theksuara në paraqitje, si dhe identitetin e personit që ka parashtruar paraqitjen, personi për pranim dhe veprim sipas paraqitjes së informatorit është i detyruar ta trajtojë si sekret zyrtar.

Personi për pranimin dhe veprim sipas paraqitjes së informatorit nuk do të kryejë aktivitete që synojnë të zbulojnë identitetin e informatorit anonim.

### **(Mënyra e paraqitjes së brendshme)**

#### **Neni 10**

Paraqitja e brendshme mund të jetë konfidenciale ose anonime.

Formulari për paraqitjen e korrupsionit dhe parregullsive të tjera përmban emrin Mali i Zi: Komuna e Tuzit; emrin, mbiemrin dhe emërtimin e informatorit (me shënim: nuk është e domosdoshme); përshkrim të shkurtër të rrezikimit të interesit publik e cila drejton në ekzistimin e korrupsionit ose parregullsie tjetër që paraqet informatori; vendin dhe datën e paraqitjes së korrupsionit ose parregullsie tjetër dhe nënshkrimin e personit për pranim dhe veprim sipas paraqitjes së informatorit.

Formularin për paraqitje të korrupsionit dhe parregullsive të tjera është pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi.

### **(Paraqitja konfidenciale dhe anonime)**

#### **Neni 11**

Paraqitja e brendshme konfidenciale është paraqitja tek personi për pranimin dhe veprim sipas paraqitjes së informatorit të cilit i është i njohur identiteti i informatorit.

Paraqitja e brendshme anonime është paraqitja tek personi për pranimin dhe veprim sipas paraqitjes së informatorit të cilit nuk është i njohur identiteti i informatorit, ose është i njohur identiteti por informatori nuk dëshiron që personi për pranimin dhe veprimin sipas paraqitjes së informatorit mos ta zbulojë të tjerëve.

Personi për pranimin dhe veprimin sipas paraqitjes së informatorit, si dhe të gjithë personat që do të veprojnë sipas paraqitjes në fjalë në Komunë, janë të obliguar që vetë paraqitjen, të dhënat e theksuara në paraqitje, si dhe identitetin e personave të cilët kanë parashtruar paraqitjen ta trajtojnë si sekret zyrtarë.

Të gjitha aktivitetet që synojnë zbulimin e identitetit të informatorit anonim janë të ndaluara.

Nëse paraqitja e brendshme ka të bëjë me personin që pranon dhe vepron sipas paraqitjes së informatorit, paraqitja i parashtrohet kryetarit të Komunës.

### **(Veprimi me paraqitjet e brendshme që kanë të bëjnë me veprat penale)**

#### **Neni 12**

Në rastin kur personi i cili ka pranuar dhe ka vepruar në bazë të paraqitjes së informatorit konstaton se kërkesa është e bazuar, dhe se bazuar në paraqitjen ose veprimet e kryera për të përcaktuar bazën e saj, mund të konstatohet se vepra në fjalë ka karakteristikat e një vepre penale, kryetari i Komunës duhet të informojë prokurorinë kompetente për këtë.

Nëse kërkesa nga paragrafi 1 i këtij neni ka të bëjë me kryetarin e Komunës, ndihmësi i kryetarit të Komunës informon zyrën e prokurorit kompetent.

### **(Trajtimi i dosjeve të brendshme lidhur me përgjegjësinë disiplinore)**

#### **Neni 13**

Në rastin kur personi për pranim dhe veprim në bazë të paraqitjes së informatorit ka përcaktuar që kërkesa ka baza, dhe se bazuar në paraqitje ose veprimet e kryera për të përcaktuar bazën e saj, mund të konstatohet se akti në fjalë kishte karakteristika të përgjegjësisë disiplinore, kryetari i Komunës, në përputhje me rregulloret përkatëse që rregullojnë çështjen e përgjegjësisë disiplinore, fillon procedurat disiplinore ndaj të punësuarit.

### **(Ndërmarrja e veprimeve për të korrigjuar pasojat e dëmshme të aktit të kryer)**

#### **Neni 14**

Në rast se kur gjatë kryerjes së veprimit për të përcaktuar bazueshmërinë e paraqitjes, kryetari do të ndërmarrë veprimet e nevojshme për të parandaluar sjelljet e mëtejshme dhe eliminimin e pasojave të dëmshme të veprës së kryer.

Nëse paraqitja nga paragrafi 1 i këtij neni kishte të bënte me kryetarin e komunës, ndihmësi i kryetarit të Komunës ndërmerr veprimet e nevojshme nga paragrafi 1 i këtij udhëzimi.

Të gjithë të punësuarit e Komunës janë të detyruar, në kuadër të kompetencave dhe autorizimeve të tyre, të ndërmarrin veprimet e nevojshme për të parandaluar sjelljet e mëtejshme dhe eliminimin e pasojave të dëmshme të veprës së kryer.

## **III. Mbrojtja e informatorëve**

### **(Mbrojtja e të drejtave të informatorit)**

#### **Neni 15**

Sipas informatorit, asnjë veprim i dëmshëm nuk duhet të ndërmerret në Komunë me synim të ndalimit të raportimit e korrupsionit ose parregullsi të tjera, d.m.th., ndëshkim për raportimin e korrupsionit ose parregullsi të tjera.

Kryetari i Komunës dhe superiorët e drejtpërdrejtë dhe indirekt ndaj informatorit, janë të detyruar të sigurojnë mbrojtjen e integritetit personal dhe profesional të informatorit në Komunë.

### **(Përgjegjësia e informatorëve për abuzim të të drejtave)**

#### **Neni 16**

Shpërdorimi i të drejtës për raportim përbën një shkelje të detyrës.

Në rast se, kur kryeni veprime për të përcaktuar bazueshmërinë e një raporti ose veprime të mëvonshme për përcaktimin e përgjegjësisë për veprimet e raportuara, përcaktohet se informatori, në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit dhe këtij Udhëzimi, ka abuzuar me të drejtën e raportimit, për të njëjtën gjë do të njoftohet Komuna për Parandalimin e Korrupsionit, në mënyrë që të iniciojë një proces kundërvajtjeje.

Nëse përcaktohet se abuzimi me të drejtën e raportimit përmban elemente të veprës penale të raportimit të rremë, komuna do të njoftojë prokurorinë kompetente për krimin e kryer.

#### IV. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

##### (Detyrimi për tu njohur me dispozitat e Udhëzimeve)

###### Neni 17

Ndihmësi i kryetarit është i detyruar të informojë të gjithë punonjësit në Komunë për të drejtat dhe detyrimet e këtij udhëzimi, dhe ta publikojë atë në tabelën e njoftimeve dhe në faqen e internetit të Komunës.

Të gjithë të punësuarit e Komunës janë të detyruar të nënshkruajnë një deklaratë se janë të vetëdijshëm për të drejtat dhe detyrimet e këtij Udhëzimi dhe Ligjit për Parandalimin e Korrupsionit, dhe ato do të regjistrohen dhe mbahen në dosjen e tyre personale.

##### (Hyrja në fuqi)

###### Neni 18

Ky Udhëzim hyn në fuqi ditën e tetë pas publikimit në tabelën e publike të Komunës së Tuzit.

Numër: 01-031/19-5898

Data: 26.09.2019

**KRYETARI I KOMUNËS**

**Nik Gjeloshaj**

*Nik Gjeloshaj*



**CRNA GORA / MALI I ZI**  
Opština Tuzi / Komuna e Tuzit

**PRIJAVLJIVANJE KORUPCIJE I DRUGIH NEPRAVILNOSTI  
PARAQITJA E KORRUPSIONIT DHE PARREGULLSIVE TË TJERA**

---

(Ime, prezime i zvanje zviždača – nije obavezno)  
(Emri, mbiemri dhe emërtimi i informatorit – nuk është i domosdoshëm)

---

---

---

---

---

---

---

---

(kratak opis ugrožavanja javnog interesa koje upućuje na postojanje korupcije ili druge nepravilnosti)  
(përshkrimi i shkurt i interesit publik i cili drejton në ekzistimin e korrupsionit ose parregullsisë tjetër)

---

(mjesto i datum prijavljivanja korupcije ili druge nepravilnosti)  
(vendi dhe data e paraqitjes së korrupsionit ose parregullsisë tjetër)

---

(Potpis lica za prijem i postupanje po prijavi zviždača )  
(Nënshkrimi i i përsoneit për pranimin dhe veprimin sipas paraqitjes së informatorit)